

Organizatat e pavarura të kulturës nga Kosova me qëllim të veprimit të përbashkët kanë nënshkruar Deklaratën e themelimit, duke caktuar qëllimet kryesore dhe zotimet e partneritetit.

Deklarata e Themelimit

Ne të poshtë nënshkruarit jemi pajtuar, në emër të organizatave tona respektive, të punojmë së bashku, me qëllim të:

- Krijimit të një rrjeti të organizatave të pavarura kulturore që është i konsoliduar, efikas, funksional, gjithëpërfshirës e i qëndrueshëm dhe që përfaqëson zërin e artikuluar dhe interesat e organizatave të pavarura të kulturës në Kosovë.
- Fuqizimin e organizatave të pavarura kulturore duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizim e programeve të tyre
 - Afirmimin e organizatave anëtare.
 - Përfshirjen e organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse
 - Rritjes së përkrahjes të skenës së pavarur të kulturës.
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Për t'i përmbushur këto qëllime, ne do të ndërmarrim, por nuk do të kufizohemi vetëm në to, aktivitetet e poshtëshënuara:

- Komunikimin dhe rrjetëzimin e organizatave të pavarura në fushën e kulturës.
 - Shkëmbimin dinamik të informacioneve dhe të përvojave.
 - Aktivitete të lobimit dhe avokimit
 - Trajnime specifike për nevojat e organizatave anëtare
 - Organizimin e debateve dhe forumeve
 - Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore

Nënshkruar më 23 Mars 2012:
Në Prishtinë, Kosovë